



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 14072/1 prot.

Vlorë, më 20.12 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2025-2027”

Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e tij të datës _____ pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 pika dh, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“ neni 33, 34, 35, 36, 37. Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes të programit buxhetor afatmesëm”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kalendarin “Për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor” sipas tabelës bshkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

Miratoi: K. Mali

Konceptoi: Xh. Kasëmi

KRYETAR

Ermal DREDHA



Kalendari për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor			
Nr.Rendor	Periudha	Aktivitetet	Axhenda e takimeve
1	Deri dt. 31.01.2024	Kryetari i Bashkise paraqet per shqyrtim dhe miratim ne keshill raportin per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave per programin buxhetor afatmesem 2025-2027.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve I raportit per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave per hartimin e programit buxhetor afatmesme 2025-2027 dhe paraqitja e raportit te Kryetari Bashkise
2	Deri dt. 01.03.2024	Keshilli i Bashkise miraton raportin e vleresimeve dhe te parashikimeve afatmesme te te ardhuarve.	
3	Deri dt. 07.03.2024	Kryetari I Bashkise pergatit dhe paraqet per miratim ne keshill tavanet pergatitore te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem ne nivel programi.	Bazuar ne vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave te miratuara dhe ne vleresimet afatmesme te transfertave te percaktuara ne Udhezimin e pergatitjes se buxhetit vendor te Ministrise se Financave dhe Ekonomisë, Ekipi per menaxhimin e programeve pergatit dhe paraqet te Kryetari i Bashkise tavanet pergatitore te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem ne nivel programi.
4	Deri dt. 15.03.2024	Keshilli i Bashkise miraton tavanet pergatitore te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem ne nivel programi.	Jo me vone se 5 dite nga miratimi I tavanave pergatitore te shpenzimeve te Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027, kryetari I Bashkise miraton Udhezimin e pergatitjes te buxhetit dhe e shperndan tek te gjitha njesite shpenzuese.
5	Deri dt. 31.05.2024	Kryetari i Bashkise i dergon Ministrise se Financave dhe Ekonomise projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesem.	Deri ne dt. 31.05.2024 dergohen ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise ne forme shkresore dhe elektronike projekt dokumenti i programit buxhetor afatmesem.
6	Deri dt. 20.06.2024	Ministria e Financave dhe Ekonomise dergon prane Keshillit te Bashkise raportin me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesem.	Ministria e Financave dhe Ekonomise analizon dhe pergatit nje raport me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesem.

7	Deri dt. 01.07.2024	Keshilli I Bashkise shqyrton dhe miraton projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2024-2026, duke shprehur edhe opinionin e tij per rekomandimet e Ministrise se Financave dhe Ekonomise.	Kryetari i Bashkise i paraqet keshillit projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2025-2027 te shoqeruar me mendimin zyrtar te Ministrise se Financave dhe Ekonomise.
8	Deri dt. 08.07.2024	Publikohet dokumenti i pare i programit buxhetor afatmesem 2024-2026 i miratuar.	Kryetari I Bashkise me masat per publikimin e dokumentit te pare te programit buxhetor afatmesem 2025-2027 te miratuar.
9	Deri dt. 18.07.2024	Keshilli Bashkise miraton tavanet perfundimtare shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem 2024-2026.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit te Programeve i raportit per tavanet perfundimtare te shpenzimeve bazuar ne Udhëzimin plotesues te pergatitjes se PBA dhe paraqitja e raportit te Kryetari. Kryetari pas vleresimit te raportit ja paraqet kete Keshillit Bashkise per miratim.
10	Deri dt. 16.09.2024	Dokumenti i programit buxhetor afatmesem 2024-2026 I rishikuar dergohet ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.	Kryetari i Bashkise merr masat per publikimin e dokumentit te programit buxhetor afatmesem 2025-2027 te rishikuar, organizon seanca degjimore me grupet e interesit dhe pergatit dokumetin e PBA te rishikuar per ta derguar ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.
11	Deri dt. 22.11.2024	Kryetari i Bashkise pergatit projektin e programit buxhetor afatmesem perfundimtar dhe e paraqet ate per miratim ne Keshillin e Bashkise.	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit te Programeve i projektit perfundimtar te PBA dhe paraqitja te Kryetari. Kryetari pas vleresimit te projektit perfundimtar te PBA ja paraqet kete Keshillit te Bashkise per miratim.
12	Deri dt. 26.12.2024	Keshilli i Bashkise miraton projektin e programit buxhetor afatmesem 2024-2026 perfundimtar.	
13	Deri dt. 30.12.2024	Publikohet dokumenti i plote i programit buxhetor afatmesem 2024-2026 i miratuar.	Kryetari I Bashkise mer masat per publikimin e dokumentit te plote te programit buxhetor afatmesem 2025-2027 perfundimtar te miratuar. Nje kopje e dokumentit te plote te Programit buxhetor afatmesem I dergohet Ministrise se Financave dhe Ekonomisë.

14	Deri dt. 22.11.2024	Kryetari Bashkise pergatit buxhetin per vitin 2024 dhe e paraqet ate per miratim ne Keshillin e Bashkise	Përgatitja nga Ekipi i Menaxhimit te Programeve i projektitbuxhetit per vitin 2024 dhe paraqitja te Kryetari.
15	Deri dt. 30.12.2024	Keshilli i Bashkise miraton projektbuxhetin vjetor 2024.	Kryetari i Bashkise pas miratimit te programit buxhetor afatmesem 2025-2027 perfundimtar , merr masat per pergatitjen e projektbuxhetit 2024 dhe ja paraqit ate per miratim Keshillit te Bashkise
16	Deri dt. 10.01.2025	Publikohet Buxheti I Bashkise per vitin 2024 i miratuar.	Kryetari I Bashkise merr masat per publikimin e dokumentit te plote te buxhetit te Bashkise per vitin 2024 te miratuar. Nje kopje e buxhetit vjetor te Bashkise dergohet ne Ministrine e Financave dhe Ekonomisë.

KRYETAR

ERMAL DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr. 14072/1 prot.

Vlorë, më 20.12 2023

RELACION

**MBI KALENDARIN E PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE**

Të nderuar Këshilltar,

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar Neni 23 e në vijim Neni 29, në Ligjin nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Neni 33 e në vijim, Udhëzimit nr.23 datë 10.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe të Udhëzimit nr.8 datë 28.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” nga Administrata e Bashkisë është përgatitur projekt vendimi i kalendarit të Projektit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 i Bashkisë Vlorë.

Në këtë kalendar bazuar ne dispozitat ligjore te përmendura më lart janë parashikuar hapat që do të ndiqen nga Administrata dhe Këshilli I Bashkisë Vlorë për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Kërkojmë nga ana e Këshillit miratimin e këtij projekt vendimi i cili për procedurë duhet miratuar përpara fillimit të zbatimit të buxhetit të vitit në vjim. Kjo me qëllim për ti hapur rrugë procedurave të mëtejshme për hartimin dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Miratoi: *K.Mali*

Konceptoi: *Xh. Kasemi*

KRYETAR

Ermal DREDHA

